

DURIMI DHE POZITA E TIJ NË ISLAM

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Falënderimi i takon vetëm Allahut. Vetëm Atë falënderojmë, Atij i kërkojmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej të keqes së veteve (shpirtrave) dhe punëve tona. Atë të cilin e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb, dhe atë të cilin humb Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, përveç Allahut, Një e i Pashoq, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

{يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَموتن إِلَّا وَأنتم مسلمون}

"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun me një devotshmëri të vërtetë dhe mos vdisni ndryshe vetëm se duke qenë muslimanë!"

{يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّ الَّذِي خَلَقَ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا}

"O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj i Cili ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm dhe pastaj krijoj prej tij shoqen e tij e prej atyre të dyve shtoi burra e gra të shumtë! Kini frikë Allahun me të Cilin ju kërkoni të drejtat tuaja dhe ruajeni farefisën! Allahu është Mbikëqyrës mbi ju."

{يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا}

"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe flisni fjalë të drejta e të vërteta! Kështu, Ai jua rregullon juve punët tuaja dhe jua fal gjynahet tuaja. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai ka arritur fitoren më të madhe."

Thënia më e mirë është Fjala e Allahut, ndërsa udhëzimi më i drejtë është ai i Muhamedit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Punët më të këqija janë shpikjet në to. Çdo shpikje është bidat (e panjohur më parë në fe) dhe çdo bidat është humbje (nga Kruga e Drejtë), ndërsa çdo humbje e ka vendin në zjarr.

Me të vërtetë, **durimi/الصبر** është prej cilësive dhe virtyteve më të larta, me të cilin çdo musliman duhet të pajiset. Gjithashtu, ai (durimi) është prej cilësive më madhështore të Allahut të Madhëruar. Sikur Allahu i Madhëruar të mos bënte durim ndaj robërve të Tij, do t'ua kishte shpejtuar atyre dënimin, porse Ai i furnizon ata nga mirësitë e Tij të shumta. Allahu i Madhëruar thotë:

وَأَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِي أَنْفُسِكُمْ فَاحْذَرُوهُ وَأَعْلَمُوا أَنَّ اللَّهَ عَفُورٌ حَلِيمٌ (235)

"Dhe dijeni se Allahu e di se çfarë keni në mendje, kështu që keni frikë Atë dhe dijeni se Allahu është gjithnjë Falës i madh, tepër Durimtar." {El Bekare 235}.

وَاللَّهُ عَفُورٌ حَلِيمٌ (101)

"E Allahu është gjithnjë Falës i madh, tepër Durimtar." {El Maide 101}.

Durimi është obligim

Shejhul-islam Ibën el Kajjim (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

"Durimi është obligim me konsensus të dijetarëve dhe kjo është gjysma e besimit. Sepse besimi ndahet në dy pjesë: një pjesë është durimi dhe tjetra falënderimi."

Durimi është: Përmbajtja e vetvetes në pakënaqësi dhe në hidhërim; mbajtja e gjuhës nga ankesa dhe ndalja e gjymtyrëve nga mëkatet.

Durimi ka qenë dhe prej cilësive më të rëndësishme tek të dërguarit e Allahut, të cilët u përgënjeshtroan e u munduan më lloj-lloj mundimesh, ndërsa ata dhe pas gjithë kësaj duruan, derisa u erdhi ndihma e Allahut. Për rëndësinë e madhe që ka durimi, Allahu i Madhëruar e ka përmendur këtë fjalë (durimin) në 90 vende në Librin e Tij, Kuranin. Prej këtyre ajeteve përmendim:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ (153)

"O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë me durim dhe me falje të namazit. Padyshim që Allahu është me durimtarët." {El Bekare 153}.

فَاصْبِرْ كَمَا صَبَّأَ أَوْلُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ (35)

"Kështu, pra, ji i duruar (o Muhamed) ashtu siç bënë durim të Dërguarit e vendosur e me vullnet të fortë." {Al Ahkaf 35}

وَاصْبِرْ وَمَا صَبْرُكَ إِلَّا بِاللَّهِ 128

"Dhe ti bëj durim, se durimi yt është vetëm prej Allahut." {En Nahl, 127}

"Ti pra duro (o Muhamed), me durim të mirë." {El Mearixh 5}

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اصْبِرُوا وَصَابِرُوا وَرَابِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ (200)

"O ju që keni besuar! Duroni dhe bëhuni më të duruar (se sa armiku juaj) dhe ruani vendin tuaj duke vendosur roje ushtarake të përhershme nga vendet ku mund t'ju sulmojë armiku juaj dhe kini frikë Allahun, që të mund të jeni të fituar." {Al Imran 200}

لَتُبْلَوْنَ فِي أَمْوَالِكُمْ وَأَنْفُسِكُمْ وَلَتَسْمَعَنَّ مِنَ الَّذِينَ آوَتْوَا الْكِتَابَ مِنْ قَبْلِكُمْ وَمِنَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا أَدَىٰ كَثِيرًا وَإِنْ تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا فَإِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ (186)

"Ju padyshim që do të mundoheni dhe do të provoheni në pasuri dhe në veten tuaj dhe vërtet që do të dëgjoni shumë gjëra të cilat do t'ju pikëllojnë prej atyre popujve të cilët morën Librat e parë para jush (jehudive dhe të krishterëve) dhe prej atyre që i vënë shok Allahut në adhurim, por, në qoftë se këmbëngulni në durimin tuaj dhe bëheni të përkushtuar, atëherë padyshim që ky do të jetë një tregues përcaktues për të gjitha çështjet më të mëdha vendimtare." {Al Imran 186}

وَالَّذِينَ صَبَرُوا ابْتِغَاءَ وَجْهِ رَبِّهِمْ 22

"Dhe ata që këmbëngulin me durim për Fytyrë të Zotit të tyre (për të arritur kënaqësinë e Tij)" { Er-Rad 22}

فَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ (48)

"Prit, pra, me durim për Vendimin e Zotit tënd." {El Kalem 48}

Rëndësia e durimit në jetën e muslimanit

1. Shpëtimi në dynja dhe në ahiret është i lidhur ngushtë me durimin. Allahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اصْبِرُوا وَصَابِرُوا وَرَابِطُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ (200)

" O ju që keni besuar! Duroni dhe bëhuni më të duruar dhe ruani vendin tuaj duke vendosur roje ushtarake të përhershme nga vendet ku mund t'ju sulmojë armiku juaj dhe kini frikë Allahun, që të mund të jeni të fituar." {Al Imran 200}

2. Allahu i Madhëruar durimtarëve ua shumëfishon shpërblimin pa masë.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَيَدْرَعُونَ بِالْحَسَنَةِ السَّيِّئَةَ وَمِمَّا أَوْلَيْنَاكَ يُوْتُونَ أَجْرَهُمْ مَرَّتَيْنِ بِمَا صَبَرُوا
رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ (54)

"Këta do të shpërblehen dyfish më tepër, sepse ata janë të duruar."

{El Kasas 54}

Disa prej selefëve kanë thënë: "Nuk ka ndonjë prej punëve të mira vetëm se shpërblimi i saj është i njohur përveç durimit".¹

Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّمَا يُوقَى الصَّابِرُونَ أَجْرَهُمْ بِغَيْرِ حِسَابٍ (10)

"Vetëm ata që janë të duruar do të marrin shpërblimin e tyre plotësisht dhe pa kufi." {Ez Zumer 10}

3. Durimi është shkak për fitoren ndaj armikut.

Allahu i madhëruar thotë:

بَلَىٰ إِن تَصْبِرُوا وَتَتَّقُوا وَيَأْتُوكُم مِّن فُورِهِمْ
هَذَا يُمَدِّدْكُمْ رَبُّكُمْ بِخَمْسَةِ آلَافٍ مِّنَ الْمَلَائِكَةِ مُسَوِّمِينَ (125)

"Sigurisht, nëse qëndroni me durim dhe me përkushtim, edhe nëse armiku vërshon e sulet mbi ju, Zoti juaj do t'ju ndihmojë me pesë mijë melekë me shenja të qarta që t'i dalloni." {Al Imran 125}

Po ashtu Allahu i Madhëruar thotë:

وَلَمَّا بَرَزُوا لِجَالُوتَ وَجُنُودِهِ
قَالُوا رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ (250)

"Dhe kur ata marshuan për t'u takuar me Xhalutin dhe forcat e tij, ata thanë (iu lutën Allahut): "Zoti ynë! Derdh mbi ne durim dhe na nxirr fitimtarë mbi popullin jobesimtar." {El Bekare 250}

¹ E njëjta gjë është edhe për agjërimin, ku shpërblimin e tij e di vetëm Allahu i Lartësuar. Transmetohet nga Ebi Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) të thotë: Allahu i Madhëruar thotë: "Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, era e gojës së agjëruarit është më e dashur tek Allahu sesa era e miskut." E ka nxjerrë Muslimi me nr. 1151.

Ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

واعلم أن النصر مع الصبر

"Dije se fitorja është me durimin."²

4. Durimi është mburojë ndaj kurtheve të armikut.

Allahu i Madhëruar thotë:

إِنْ تَمَسَسَكُمْ حَسَنَةٌ تَسُؤْهُمْ وَإِنْ تُصِيبَكُمْ سَيِّئَةٌ يَفْرَحُوا بِهَا وَإِنْ تَصْبِرُوا
وَتَتَّقُوا لَأَيُّرُكُمْ كَيْدُهُمْ شَيْئًا إِنَّ اللَّهَ بِمَا يَعْمَلُونَ مُحِيطٌ (120)

"Por, nëse ju qëndroni të duruar dhe bëheni të përkushtuar ndaj Allahut, as dëmi më i vogël nuk do t'ju vijë nga dinakëria e tyre. Sigurisht, Allahu është Rrethues për gjithçka që ata bëjnë." {Al Imran 120}

5. Allahu i Madhëruar i urdhëron robërit e Tij që në çështjet e tyre të kërkojnë ndihmë me durim dhe namaz.

Allahu i madhëruar thotë:

وَاسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ وَإِنَّهَا لَكَبِيرَةٌ إِلَّا عَلَى الْخَاشِعِينَ (45)

"Dhe kërkon ndihmë me durim dhe me falje (të namazit)." {El Bekare 45}
Po ashtu Allahu i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ (153)

"O ju që keni besuar! Kërkon ndihmë me durim dhe falje të namazit.
Padyshim që Allahu është me të duruarit." {El Bekare 153}.

6. Durimi gjatë thirrjes për në fenë e Allahut.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَاصْبِرْ وَمَا صَبْرُكَ إِلَّا بِاللَّهِ 128

² Hadithi është *Sahih*. "Musnedi" i Imam Ahmedit 12/126/1/

"Dhe ti bëj durim, se durimi yt është vetëm prej Allahut." {En Nahl, 127}

Shejhul islam, Muhamed bin Abduluehab (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

"Dije, Allahu të mëshiroftë, se është detyrë mbi ne që t'i mësojmë katër çështje:

E para: Dija

E dyta: Të punuarit me këtë dije

E treta: Thirrja për tek kjo dije.

E katërta: Durimi

وَالْعَصْرُ (1) إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ (2) إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ
وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ (3)

"(Betohem) për kohën! Me të vërtetë që njeriu është në humbje të plotë. Përveç atyre që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, që e këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën edhe që këshillojnë të jenë të durueshëm." {El Asër, 1-3}.³

- Fjala e Allahut: "إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا" - "Përveç atyre që besojnë" ka për qëllim dijen, sepse besimi nuk mund të jetë vetëm se me dije.

- Fjala e Allahut: "وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ" - "dhe punojnë mirësi e drejtësi" ka për qëllim të punuarit me këtë dije.

- Fjala e Allahut: "وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ" - "këshillojnë njëri-tjetrin për të vërtetën" ka për qëllim Thirrjen.

- Fjala e Allahut: "وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ" - "e këshillojnë të jenë të durueshëm." Durimi ndaj dëmeve. Kjo sure e shkurtër i përmban të katër çështjet.

Dhe Lukmani (alejhis selam) kur birit të tij i tha:

يَا بُنَيَّ أَقِمِ الصَّلَاةَ وَأْمُرْ بِالْمَعْرُوفِ وَانْهَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَأَصْبِرْ عَلَىٰ مَا أَصَابَكَ
إِنَّ ذَلِكَ مِنْ عَزْمِ الْأُمُورِ (17)

"O biri im! Fale rregullisht namazin, urdhëro për punë të mira dhe ndalo nga të këqijat si dhe bëj durim për çfarëdo që të bie e të ndodh. Vërtet që këto janë disa nga detyrimet e rëndësishme." {Lukman, 17}

³ Shkëputur nga libri "Tri Parimet". Lus Allahun që ta lehtësojë botimin e tij!

Pasi ai (Lukmani, alejhis selam) e këshillon të birin që të urdhërojë për punë të mira dhe të ndaloj nga të këqiat, tha:

وَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا أَصَابَكَ

"si dhe bëj durim për çfarëdo që të bie e të ndodh."

Sepse ai i cili urdhëron për punë të mira, ndalon nga të këqiat dhe fton për tek Allahu, ai (thirrësi) gjatë kësaj do të bëhet subjekt i sulmeve dhe dëmeve nga njerëzit, prandaj ai ka nevojë për durim gjatë kësaj thirrje për tek Allahu i Madhëruar.⁴

7. Durimi ndaj sprovave.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَلْيَبْئُوتَكُمْ بَشْيَاءٍ مِّنَ الْخَوْفِ وَالْجُوعِ وَنَقْصٍ مِّنَ الْأَمْوَالِ وَالْأَنْفُسِ وَالثَّمَرَاتِ
وَبَشِّرِ الصَّابِرِينَ (155)

"Dhe sigurisht që Ne do t'ju provojmë ju me gjëra të tilla si frikë, uri, humbje të pasurisë, të jetës, të frutave, por përgëzimet janë për të duruarit."
{El Bekare 155}

8. Transmetohet nga Makul bin Jesar *merfuan*: "Besimi më i mirë është durimi dhe falja." {*Es Sahihah* 1495}

Ajetet dhe hadithet në lidhje me durimin janë të shumta, porse ne po mjaftohemi me kaq.

Disa hadithe të dobta në lidhje me durimin

1. "Besimi është dy pjesësh: gjysma në durim dhe gjysma tjetër në falënderim." {*Daif Xhiden*} ["Shuabul Iman" i El Bejhakiut] Enesi. {*Silsiletu ed Daifeh* 625}. F. 339
2. "Durimi është prej besimit si vendi i kokës për trupin." {*Daif Xhiden Merfuan* dhe *Daif Meukufan*} ["Musnedu el Firdeu" i Dujlemi] nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dhe ["Shuabul Iman" i Bejhakiut"] nga Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). {*Silsiletu ed Daifeh* 3793.}.

⁴ Shkëputur nga "Muhadaratun fil akideti ued dauah." shejh Salih el Feuzani (Allahu e ruajt!)

3. "Durimi është gjysma e besimit, ndërsa El Jekin është i gjithë besimi." {*Daif*} ["El Hiljetu" Ebu Nuajm] dhe ["Shuabul Iman" i Bejhakiut"] nga Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!). {*Silsiletu ed Daifeh* 499}.

Lutja jonë e fundit është:

رَبَّنَا أفرع عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَوَقَّنَا مُسْلِمِينَ (126)

"Zoti ynë! Na dhuro durim dhe na bëj që të vdesim muslimanë." {Al Araf 126} ndaj dëmeve që mund të ndodhin gjatë kësaj thirrjeje.

Argument për këtë është Fjala e Allahut të Madhëruar:

Përgatiti dhe përktheu: Xhabir SHEME